



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno / Predato Received / Delivery	20-01-2022	3	viti god year
Organ / Alesia Organ / Jedinstva Org / Unit	Br / Prot Br / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIPINSHOK	611/2023		1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1045/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.Nr.1045/2022, të datës 23.11.2022 të ankuesit

kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.01.2023 mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.Nr.1045/2022 e datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET NË FUQI, Vendimi i datës 07.11.2022 me numër protokollit 01-116/01-25231 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka shqyrtuar ankesën e ankuesit me nr.A.nr.713/2022 dhe më datë 14.10.2022 ka nxjerrë Vendimin me nr.A.Nr.713/2022 duke shfuqizuar Vendimin nr.01-116/02-19210 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni disiplinor, me detyrim që në afatin prej 15 ditësh ta bëjë rishqyrtimin e rastit lidhur me iniciimin e procedurës për ankuesin Qazim Ibrahim, me qëllim të përcaktimit të saktë të shkeljes disiplinore nga ana e ankuesit.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës me qëllim të zbatimit të Vendimit me A.Nr. 713/2022 të 14.10.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.11.2022, me numër protokollit 01-116/01-25231, ka nxjerr vendim me të cilin vendim ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore „ Ndalimi i 20% të pagës për përudhen dy mujore“.

Ankuesi i pakënaqur me vendim e datës 07.11.2022, me numër protokollit 01-116/01-25231, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës me datë 23.11.2022 ka parashtruar ankesë në Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila ankesë është protokolluar me numër

protokolli 7337/2022, me pretendimet ankimore kundër vendimit të datës 07.11.2022, me numër protokoll 01-116/01-25231, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës, lidhur me shqiptim e masës disiplinor "Ndalimi i 20% të pagës për përudhen dy mujore".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr 1045/2022, datës 23.11.2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 07.11.2022, me numër protokoll 01-116/01-25231, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës; Deklaratë e datës 27.09.2017; Pasaporta e Bim Bera; Vendimi i datës 01.03.2017, me numër protokoll Nr. 05/134; Deklarata nën betim e datës 17.08.2017; Kërkesë për dokumentet e gjendjes civile e datës 27.09.2017, nga Bin Bera; Certifikatë e datës 12.9.2006; Vendimi A.Nr.713/202i datës 14.10.2022, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 18.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër protokoll 01-116/02-19 210, i datës 29.07.2022 i Komisionit Disiplinor; Pasaporta e Bim Bera; Akt Emërimi i datës 13.12.2021, me numër protokoll 01-112/02-37385; Përshkrimi i detyrave të Punës; Kërkesë e datës 28.06.2022, me numër protokoll 01-11601-16405, për iniciimin e procedurës disiplinore; e- maili i datës 23.06.2022; Njoftimi i datës 23.06.2022, me numër 772, i Inspektoratit të ARC/ MPB; Certifikata e lindjes e datës 26.12.1998; Përgjigje në ankesë e datës 16.09.2022, me numër protokoll 5458/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit Qazim Ibrahim, i cili pretendon se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës, me datë 07.11.2022, me numër protokoll 01-116/01-25231 i ka shqiptuar masën disiplinore „ Ndalimi i 20% të pagës për përudhen dy mujore“.

Udhëheqësja e Sektorit të Gjendjes Civile në Komunën e Gjakovës me datë 28.06.2022 ka bërë kërkesë për iniciimin e procedurës Disiplinore tek Komisioni Disiplinor, pas njoftimit me numër 02 nr. 772 të datës 23.06.2022 të Inspektoratit të Regjistrimit të Gjendjes Civile të Ministrisë së Punëve të Brendshme, sepse me rastin e regjistrimit të qytetarit BB ankuesi duke mos përmbushur detyrat e punës sipas dispozitave ligjore dhe nën ligjore në fuqi ka fut në sistemin elektronik të gjendjes civile qytetarin me iniciale BB duke i krijuar edhe nr. personal 125085567.

Kolegji ka trajtuar pretendimet e ankuesit i cili pretendon se me rastin e regjistrimit në regjistrin civil të qytetarit me iniciale BB ka vepruar konform të gjitha procedurave dhe ka bërë verifikimin e nevojshëm për regjistrimin e qytetarit me iniciale BB, Kolegji pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura nga palët ka konstatuar se ankuesi me rastin e regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile dhe krijimit të nr. Personal për qytetarin me iniciale BB, ankuesi në cilësinë e personit zyrtar nuk ka përmbushur autorizimet ligjore, sepse nga shkresat e lëndës konstatohet se në dosjen e regjistrimit në regjistrat e gjendjes civile lidhur me regjistrimin e qytetarit BB ka munguar verifikimi i dokumenteve konform Udhëzimit Administrativ MPB Nr.24/2015 për Regjistrimin e Mëvonshëm në Regjistrat e Gjendjes civile, ku ankuesi nuk ka vërtetuar dhe nuk ka pasur dëshmi për regjistrimin në gjendje civile të prindërve të qytetarit me iniciale BB ,sepse nuk ka pasur mundësi të bëhet regjistrimi i tillë i më vonshëm, pa dëshminë se prindërit janë në sistemin e gjendjes civile, këtë e vërteton edhe shkresa e Inspektoratit të ARC-së e datës 26.03.2022 ku njoftohen se kanë bërë inspektim në Zyrën e Gjendjes Civile në Junik dhe prindërit e qytetarit me iniciale BB nuk janë gjetur në regjistrat e gjendjes civile as në kopje fizike dhe as në kopje elektronike. Gjithashtu ankuesi duke mos i përmbushur detyrat e punës sipas ligjit, ka bërë regjistrimin e qytetarit në një libër të veçantë e cila është e ndryshme për nga forma, ndërsa të gjitha librat në kuadër të njëjtit vit janë të njëjtës formë.



Prandaj Kolegji konstaton se me këto veprime konkret ankuesi në rastin e veprimeve si zyrtar përgjegjës i gjendjes civile ka vepruar në kundërshtim me nenin 31 paragrafi 1, 2, 3 nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3, dhe neni 3, të LIGJI Nr. 04/L-003 Për Gjendjen Civile, ku thuhet se; 1. Regjistrat themeltarë të gjendjes civile janë dokumente, të cilat i përmbledhin të gjithë përbërësit e gjendjes civile, sipas vendit ku ka ndodhur fakti i përbërësve të gjendjes civile. 2. Regjistrat themeltar të gjendjes civile janë: 2.1. regjistri i të lindurve; 2.2. regjistri i të martuarve; 2.3. regjistri i të vdekurve. 3. Zyra e gjendjes civile mban regjistrat themeltar të gjendjes civile, në formë të shkruar dhe elektronike. 4. Llojet, forma, përmbajtja, futja e të dhënave, mënyra dhe afati i mbajtjes së regjistrave themeltar të gjendjes civile si dhe Regjistrave të veçantë nga neni 35 i këtij ligji, përcaktohen me akt nënligjor nga Ministri.

Gjithashtu ankuesi me veprimet e lartshënuar ka vepruar në kundërshtim me nenin me nenin 25 paragrafi 1, 2, 3 të Ligjit Nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike.

Kolegji ka konstatuar se lidhur me shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit Komisioni drejtë ka konstatuar gjendjen faktike dhe juridike dhe ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nenin 46 paragrafi 1, 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës”.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.NR.1045/2022**

Rutshir KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

Ankuesit

Kryetarit të Komunës së Gjakovës;

Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, dhe

Arkivit të KPMSHCK-së.